

KËRKESË
Nr. 198/3, datë 1.6.2015
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajt-shme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Tiranës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të rikonstruksionit të rrugës së “Filantos” të qytetit, në Bashkinë e Tiranës është 2.110.017 (dy milionë e njëqind e dhjetë mijë e shtatëmbëdhjetë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1- javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTËR I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN
PËR NDËRTIMIN E RRUGËS SË FILANTOS

NR.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe e përgjithshme m ²	Sipërfaqe e prekur m ²	Çmimi për m ²	Vlefë në lekë	Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë
1	Eduard Fran Kaçi	8330	4/313	500	59	35763	2,110,017	Shkr.nr.prot.11286,dt.02.07.2013
						Shuma	2,110,017	